



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:213605
Datë: 28.02.2024
Numri i dokumentit: 05390094

KPPP.nr.1748/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtar Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovë” (RBKO), me seli në Prishtinë, Rr.”Robert Doll” nr.99, kundër debitorëve 1.) N.Sh. Onstituti “...” / Instituti ... B.I. me NRB:70579138, me pronar M.P., me seli në Prishtinë, Mati I Rr.”...” Nr....lam...., 2.)M.P. me adresë në Prishtinë, Rr.”...”, dhe 3.) A.P. me adresë në Prishtinë, Rr.”...”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.269/21 të datës 16.08.2021, të Përmbartuesit Privat Saranda Rexhepi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit A.P. me adresë në Prishtinë, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.269/21 të datës 16.08.2021, të Përmbartuesit Privat Saranda Rexhepi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.269/21 i datës 16.08.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Saranda Rexhepi.

A r s y e t i m

Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Saranda Rexhepi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbartimor me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Marrëveshjes mbi Kredinë nr.200714119 të datës 14.06.2018, Marrëveshjes mbi Pengun e datës 14.06.2028, Marrëveshjes mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznes kredit kartelës me nr.229.06.2018 dhe Konfirmimin e regjistrimit R-20180620-273 të datës 20.06.2018, duke detyruar debitorët t’ia paguajnë borxhin e përgjithshëm në shumë prej 9,904.29 €, ka urdhëruar të gjitha Institucionet Financiar se në rast se ka mjete atëherë të transferohen përmes llogarisë së

veçantë të organit përbarues me qëllim të përmbylljes së obligimit. Në rast të mos realizimit me anë të llogarive bankare, të sekuestrohet kolaterali i debitorëve sipas kontratës së pengut dhe të njëjtat ti dorëzohen kreditorit për ti shitur, që nga çmimi i shitblerjes të përmbushet obligimi i debitorëve.

Kundër urdhrin përbarimor në afatin e paraparë ligjor prapësim ka ushtruar debitori i tretë, e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, ndër të tjerash ka theksuar se debitorët kanë lidhur kontratë për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në bazë të cilës do të financonte pas investimit 60 % të projektit, ndërsa me vendimin ref. AZHB.07/04/03/3600/2019, i refuzon debitorëve përkrahjen financiare të projektit dhe i përjashton debitorët e kësaj procedure nga programi për pagesa direkte apo subvencione për 3 vite. Tutje ka shtuar, se sot jemi të zhytur në detyrime jo vetëm ndaj këtij kreditori, por edhe kreditorëve të tjerë, për momentin jam i pa punësuar, prind i një familje 7 anëtarësh dhe ky përbarim e cenon direkt ekzistencën tonë. I ka propozuar gjykatës që të anuloj urdhrin përbarimor.

Kreditori në përgjigje në prapësim i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të tretë i të pabazuara, ndër të tjerash ka theksuar se debitori nuk ka paraqitur prova për të mbështet prapësimin e tij dhe nga të cilat shihet qartë se debitori qëllimin kryesor e ka keqpërdorimin e të drejtave procedurale me qëllim të prolongimit të procedurës së përbarimit e rrjedhimisht realizimit të kërkesës së kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin si të pa bazuar dhe urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pa bazuar, andaj, të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument përbarues dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, si dhe nenin 5 par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.7, përcaktohen dokumentet përbaruese siç janë: *“...kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit...”* dhe sipas nenit 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore përcaktohet se dokument përbarues paraqet *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*. Me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Gjykata duke vlerësuar Marrëveshja mbi Kredinë nr.200714119 të datës 14.06.2018, Marrëveshjes mbi Pengun e datës 14.06.2028, Marrëveshja mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznes kredit kartelës me nr.229.06.2018, gjeti se të njëjtat janë paraqitur në origjinal, janë hartuar në formën e paraparë me ligj, dhe të njëjtat janë regjistruar në regjistrat publik, fakt ky që vërtetohet nga Konfirmimin e regjistrimit R-20180620-273 të datës 20.06.2018, dhe si të tilla përbëjnë bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 22, pika 1.7 dhe 1.7a, lidhur me nenin 27 të LPP-së, për të qenë dokumentet të përbarueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përbarim.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera te debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përbarimore.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorëve ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 par.1 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1748/22, datë 28.02.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.